

# RAPORTI INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

## 1. Titulli i projekt aktit

Projektvendimi “Udhërrëfyese për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026-2030”.

## 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtrimin e kohëzgjatjes.*

Projektvendimi “Për miratimin e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026-2030” synon të miratojë një dokument strategjik të rëndësishëm, i cili orienton përpjekjet kombëtare drejt përmbushjes së Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Qëllimi kryesor i këtij projektvendimi është miratimi i një dokumenti strategjik, orientues, i cili përcakton drejtimit kryesore për arritjen e OZHQ-ve në Shqipëri, nëpërmjet një qasjeje të integruar që ndërlihdh prioritetet kombëtare (SKZHIE 2030) me procesin e integritimit evropian dhe me kuadrin ndërkombëtar të zhvillimit të qëndrueshëm. Udhërrëfyese synon të përmirësojë koordinimin ndërinstitucional, të forcojë planifikimin e bazuar në evidencë dhe të mundësojë përcaktimin e synimeve të matshme për vitin 2030, në funksion të rritjes së efektivitetit të politikave publike.

Konsultimi publik për projekt-vendimin “Udhërrëfyese për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026–2030” është zhvilluar në një periudhë prej 20 (njëzetë) ditë pune, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik. Projektvendimi është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) në datën 3.4.2026 deri në datë 6.5.2026, proces gjatë të cilit nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projekt-aktin.

## 3. Metoda e konsultimit

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Bazuar në urdhrin nr. 76, datë 27.6.2023, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit, i cili ka bashkërenduar procesin teknik të hartimit të tij, duke siguruar përputhshmërinë/linjëzimin me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030 dhe dokumentet e tjera strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale.

Në fazën e hartimit të dokumentit janë zhvilluar mbi 20 takime pune në nivel teknik, përgjatë periudhës 2023-2025 me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC), anëtarëve të grupit ndërinstitucional të punës, ekspertëve të angazhuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara në Tiranë, si dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore (MF, MIE, MEI, MSHMS, MD, INSTAT, AKSHI), organizatave ndërkombëtare të përfshira në proces (UN, FAO, EEAS), Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Mesdhetar i Tiranës.

Këto konsultime teknike kanë shërbyer për identifikimin dhe përzgjedhjen e treguesve strategjikë të rekomanduar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të përdorur nga vendet që ndjekin zbatimin e Agjendës 2030, si dhe për përcaktimin, aty ku ka qenë e mundur, të objektivave konkrete për vitin 2030, në përputhje me kuadrin strategjik sektorial të miratuar.

Metodat e përdorura për konsultim ishin:

- 1.Udhërrëfyesi është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, RENJK, në periudhën 3.4.2026-6.5.2026.
- 2.Udhërrëfyesi iu është dërguar për komente të gjithë aktorëve të përfshirë në proces.

Në RENJKP janë regjistruar 300 shikime dhe asnjë koment.

#### **4.Palët e interesit të përfshira**

*Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.*

*Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.*

*Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.*

Në procesin e hartimit dhe konsultimit të projekt-aktit “Udhërrëfyesi për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026–2030”, kanë marrë pjesë:

- 1.institucione shtetërore:
  - Ministria e Financave (MF);
  - Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise (MIE);

- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale (MSHMS);
- Ministria e Drejtësisë (MD),
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);

2.organizata ndërkombëtare:

- United Nations (UN),
- Food and Agriculture Organization (FAO);
- European External Action Service (EEAS).

3.institucione të arsimit të lartë:

- Universiteti i Tiranës;
- Universiteti Mesdhetar i Tiranës,

4.ekspertë teknikë të angazhuar në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe monitorimit të Agjendës 2030.

### **5.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;*

*Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;*

*Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Nga procesi i konsultimit të projekt-aktit, ka patur 2 (dy) komente/sugjerime.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Vendosja e objektivave për indikatorët sasiore të SDG-ve të bëhet në mënyrë të harmonizuar	Sipas kësaj metodologjie, Shqipëria krahasohet me vende që kanë pasur nivele të ngjashme zhvillimi dhe që	UN	Pranuar	Përcaktimi i objektivave realiste dhe të arritshme.

dhe të bazuar në të dhena konkrete. Në këtë kuadër, është propozuar përdorimi i metodologjisë “Nearest Neighbour (NN)” për përcaktimin e targeteve deri në vitin 2030.	kanë arritur progres të suksesshëm në të kaluarën.			
Janë sugjeruar disa ndryshime terminologjike dhe përditesime në draftin e Udhërrëfyesit.		UN Women  United Nations Environment Programme (UNEP)	Pranuar	Reflektuar